

HAMIT KABA**BABA FAJA NË VËSHTRIMIN E DISA BURIMEVE
BRITANIKE E AMERIKANE***

Përgjithësisht, klerikët shqiptarë janë treguar luajalë ndaj politikës, patriotë dhe mbështetës të pavarësisë së vendit, pavarësisht nga pozicioni i tyre hierarkik dhe qendrave botërore fetare, nga të cilat vareshin. Pjesëmarrja e tyre në jetën politike të vendit ka qenë një fenomen jo i zakonshëm, por sidoqoftë atë e kemi ndeshur jo rrallë në historinë tonë. Baba Faja ishte njeri prej tyre. Ai ishte njëherazi njeri i fesë, luftëtar i lirisë dhe figurë politike e ushtarake.

Baba Faja, të cilit i kushtohet aktiviteti i sotëm shkencor, përbën një shembull të qartë të klerikut atdhetar bektashi, i cili u përfshi në qëndresën antifashiste të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Tek personaliteti i Baba Fajës janë ngjizur qartazi tiparet e një nacionalisti patriot, kleriku atdhetar dhe drejtuesi politik, i cili nuk ngurroi të bashkëpunojë me lëvizjen çlirimtare në luftë kundër pushtuesit, të udhëhequr nga Partia Komuniste, ndonëse ajo inspirohej nga një ideologji komuniste, e huaj për shumicën e shqiptarëve dhe si tregoi koha, kundërshtarë deri në likuidim e fesë dhe institucioneve të saj në Shqipëri. Përfshirja e Baba Fajës përkrah lëvizjes çlirimtare, ishte në realitet një zgjidhje personale e tij, por edhe shprehje e nevojës së lëvizjes partizane, për të pasur në radhët e veta nacionalistë patriotë, të njohur dhe me influencë në vend. Baba Faja është gjithashtu mëshirim i sentencës së bektashinjeve se “pa atdhe nuk ka fe”.

Pozita e Baba Fajës gjatë dhe pas çlirimit, figura e tij e veçantë dhe e besimit që ai përfaqësonte kanë tërhequr vëmendjen e disa prej anëtarëve të misioneve britanike e amerikane në Shqipëri. Figura e tij është produkt kompleks, i atdhetarizmit tradicional të besimtarëve të këtij komuniteti dhe i besimit bektashian. Në një studim amerikan të vitit 1945, për besimet fetare në Shqipëri, bektashinjtë e Shqipërisë do të karakterizoheshin me fjalët: “tolerant dhe të prirur për thjeshtësi..,

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore kushtuar Baba Faja Martaneshit me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Tiranë, 23 dhjetor 2010.

tregojnë respekt për gruan (të cilat janë të lira të shkojnë në teqe); atje (në teqe) predikohet dashuria vëllazërore, barazia sociale dhe dinjteti i punës. Ata e shohin zotin si autoritet madhor, por askush nuk mendohet i perfeksionuar. Bektashinjtë, pranojnë lirisht të krishterët, myslimanët dhe urdhrat e tjerë fetarë.., pa u kërkuar të heqin dorë nga besimet e tyre të hershme. Bektashizmi, përbën tashmë një pluralitet ndërmjet shqiptarëve”¹.

Baba Faja, si dëshmojnë sidomos burimet britanike ishte një person i njohur, dhe me famë gjatë luftës, me rezonancë jo vetëm krahinore por edhe më gjerë. Cilësitë vetjake dhe detyra e tij e veçantë gjatë luftës, si person i zgjedhur nga Shtabi i Përgjithshëm për t’i qëndruar afër Misionit Britanik të drejtuar nga gjenerali Dejvis, në kohën e Operacionit Armik të Dimrit, do ta bënin Baba Fajën një njeri, që do të zinte vend në dokumentet, ditarët dhe librat me kujtime të shkruar nga disa prej anëtarëve të misioneve britanike në Shqipëri. Baba Faja, si shfaqet në këto burime, ka jo vetëm formatin e luftëtarit dhe personit të prirur për të ndihmuar e bashkëpunuar, por edhe të një personi që mishëronte cilësitë e një shqiptari tradicional. Baba Faja përmendet pothuajse në të gjitha kujtimet e oficerëve britanikë, por në veçanti ndërmjet atyre që kaluan kohët e vështira të dimrit të egër të vitit 1943-1944. Në dimrin e këtij viti të vështirë për të gjithë, si për LNÇI dhe Shtabin e Përgjithshëm të saj, ashtu edhe për Misionin britanik të atashuar pranë tij, Baba Faja ka pasur një detyrë të veçantë, të cilën ai e kreu më së miri, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe njohjet e tij të gjera në krahinën e Martaneshit e Çermenikës.

Për Baba Fajën ka shkruar Xhulian Emeri (Xhulian Amëri), në librin “Bijtë e Shqipes”, gjenerali Dejvis(Edmënt Frank Dejvis) te “Aventura Ilire”, oficerët britanikë: Tilman (William Tilman), Emeri e Piter Kemp (Pitër Kemp) në librin “Kujtime që nuk shlyhen” etj. Baba Faja përmendet gjithashtu në librin “Fitorja e Hidhur” të britanikut Rexhinald Hibbert (Rexhinëld Hibërt), në librin “Shqipëria gjatë Luftës, 1939-1945”, të historianit të njohur amerikan Bernd Fisher (Bernd Fisher), tek “Kombi dhe Feja në Shqipëri 1920-1944”, i Roberto Moroko dela Roka, tek “Misioni Amerikan në Shqipëri” i Peter Lucas (Pitër Lukës), dhe sidomos tek libri më i fundit “Provinca më e egër, SOE në tokën e

¹ *National Archives and Record Administration (NARA)*, Roll 2, Year 1945, File 875, pp. 3-4.

shqiponjave”, i botuar në Londër në vitin 2009, nga autori më i ri, britaniku Roderick Bailey (Rodrik Bejli). Por, Baba Faja përmendet edhe në një varg dokumentesh që gjenden në arkivat e huaja, në ditarët e mbajtur nga anëtarët e Misioneve Britanike në Shqipëri, në vitet e luftës etj. Ndër këta të fundit, unë do të përmendja sidomos ditarin e kolonelit anglez Arthur Nikols, të mbajtur ditë pas dite, në muajt nëntor 1943-janar 1944. Ditari i kolonelit Nikols-shefit të stafit të gjeneralit Dejvis, u gjet tek të afërmit e tij pak vite më parë, dhe pikërisht në vitin 2002.

Duke dashur të jem konkret, për disa nga karakterizimet e të huajve për Baba Fajën, do të desha të përmendja disa prej tyre. Xhulian Emeri, duke shkruar për çetat nacionaliste të udhëhequra nga Abaz Kupi, Myslim Peza dhe Baba Faja shprehet: “Grupi i dytë udhëhiqej nga Baba Faja, një baba bektashi, të cilin italianët kishin dashur ta arrestonin, sepse kishte denoncuar hapur qeverisjen e tyre. Duke i thirrur patriotizmit të tyre, duke u premtuar armë dhe flori, gjë për të cilat ata kishin nevojë të madhe, Mustafa Gjinishi arriti t’ua mbushte mendjen dy veteranëve, që të bashkoheshin me partizanët”². Po kështu, Xhulian Emeri përmend emrin e Baba Fajës si një ndër 10 anëtarët e Këshillit të LNÇ.

Në librin “Kujtime që nuk shlyhen”, Baba Faja cilësohet si “një dervish bektashi trim dhe i alkolizur, një kundërshtar i hidhur i italianëve, i cili komandonte një çetë të fortë”³. Autorët e këtij libri e konsiderojnë përfshirjen e çetave nacionaliste të udhëhequra nga Myslim Peza e Baba Faja, përkrah Lëvizjes Nacionalçlirimtare si fitore të komunistëve, të cilat u shërbyen atyre si mjet për të larguar dyshimet e njerëzve që nuk pranonin ideologjinë komuniste. Kjo gjë u arrit falë aftësive bindëse të Mustafa Gjinishit, komunist me profil të qartë patrioti. Një tjetër britanik, ish anëtar i Misionit Anglez në Shqipëri, Rexhinald Hibbert, do të shkruante për Baba Fajën, në librin e tij “Fitorja e Hidhur”: “Na u paraqit Baba Faja, dervish bektashi i famshëm për rezistencën e tij të hershme kundër italianëve. Ai solli me vete jehonën e madhështisë e të karakterit të kohërave të vjetra. Ai, me Myslim Pezën dhe Abaz Kupin, i kishin dhënë Lëvizjes Nacionalçlirimtare ngjyrimin e rezistencës “nacionale” kur ajo u formua në Pezë, në shtator 1942. Ai, shkruhet më tej për Baba Fajën, ishte pjesërisht përgjegjës për Dejvis-in dhe kuarterin e misionit

² Julian Amery, *Bijtë e Shqipës*, Tiranë: “Lumo Skëndo”, 2002, f. 78-79.

³ William Tilman, Julian Amery, Peter Kemp, *Kujtime që nuk shlyhen*, Tiranë: “Toena”, 1997, f.197.

gjatë ofensivës totale gjermane nga fundi i atij viti. Ai ishte nënkryetar i LNC⁴.

Rezistencën e hershme të Baba Fajës dhe të çetës së tij kundër italianëve, e më pas kundër gjermanëve, e ka nënvizuar edhe Bernd Fisher. “Në grupin hershëm të udhëheqësve të qëndresës, shkruan ai, bënte gjithashtu pjesë edhe kleriku bektashi Baba Mustafa Martaneshi, i njohur si Baba Faja, babai i teqesë së Martaneshit, i cili vepronte në afërsi të Elbasanit, dhe qe i zoti të mblidhte rreth vetes mjaftë ithtarë, duke theksuar natyrën antiislamike të Italisë fashiste, si edhe rreziqet që paraqiste imperializmi italian për bashkëbesimtarët në Turqi dhe në Egjipt. Si rrjedhojë e deklaratave të tij antiitaliane, veprimtarisë së herëpashershme luftarake dhe bashkëpunimit me lëvizjen komuniste që po lindte, Baba Faja u bë një nga njerëzit më të kërkuar në Shqipëri⁵. Nga ana e vet, Roberto dela Roka do të shkruajë në librin e tij se “teqetë bektashiane në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, do të bëheshin qendra të rezistencës kundër italianëve dhe pastaj kundër gjermanëve. Autori përmend emrat e dy baballarëve më të spikatur bektashinj, të Baba Fajës në Shqipërinë e Mesme dhe të Baba Fejzos në zonat e jugut të vendit. Pjesëmarrjen e hershme të bektashinjve në rezistencë, autori do ta shpjegonte me “patriotizmin tradicional të urdhrat të dervishëve në Shqipëri dhe me kujtimet e tij të lavdishme historike”. Duke ju referuar shifrave të eksponentëve bektashinj, autori do të përmendte pjesëmarrjen në rezistencë të 6000 bektashinjve⁶.

Libri “Provinca më e egër, SOE në tokën e shqiptonjave” është një studim i mirëfillt shkencor, që ndryshon nga një numër shkrimesh që i përkasin zhanrit të kujtimeve. Bejli, ka shfrytëzuar burime të ndryshme dhe të plota, duke përfshirë arkivat britanike, gjermane, italiane, amerikane, një bibliografi të gjerë dhe sidomos ditarët e mbajtur gjatë kohës së luftës nga britanikët e SOE në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë, ai ka shfrytëzuar ditarin e kolonelit Nikolls (Nicholls Arthur). Gjenerali Dejvis, së bashku me stafin e vet të drejtuar nga koloneli Nikolls dhe një numër tjetër britanikësh, u gjendën në kushte shumë të

⁴ Reginald Hibbert, *Fitorja e Hidhur*, Tiranë: Shtëpia e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1992, f. 344

⁵ Bernd Jurgen Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945*, Tiranë: “Çabej”, 2000, f. 158

⁶ Roberto Moroco dela Roka, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë: “Elena Gjika”, 1994, f. 2002.

vështira në dimrin e vitit 1943-44. Ata përjetuan situata të vështira gjatë operacionit të dimrit në zonën Martanesh-Çermenikë. Gjenerali anglez u plagos dhe u zu rob nga ballistët shqiptarë të drejtuar nga oficerë gjermanë. Ditari i kolonelit Nikolls përshkruan pak a shumë po ato ngjarje për të cilat shkroi edhe gjenerali Dejvis pas luftës, por ditari ka vlera origjinale, sepse është shkruar në kohën kur ndodhën ngjarjet dhe është më preciz nga pikëpamja kohore. Zymtësia e ngjarjeve të përshkruara në ditarin e Nikolls, duhet të shpjegohen përveç të tjerave edhe me gjendjen e tij të vështirë shëndetësore, me gangrenën e cila solli e vdekjen e tij, pak kohë pas vendosjes së tij në Valias të Tiranës, në shtëpinë e Insan Toptanit. Gjykimet e kolonelit Nikolls për ngjarje dhe persona, duke përfshirë edhe Baba Fajën, sipas meje, janë shkruar pa rezerva dhe ashtu si i mendonte ai. Por, duhet të kuptojmë se gjykimet e tyre mbi Shqipërinë dhe shqiptarët janë gjithashtu produkt i kulturës, arsimimit dhe diferencave të mëdha në mënyrën e jetesës, që ekzistonin ndërmjet shqiptarëve dhe britanikëve. Pavarësisht nga dallimet ndërmjet tyre, si gjenerali Dejvis edhe koloneli Nikolls e shohin Baba Fajën si një person luftarak, të sinqertë, të prirur për të ndihmuar dhe mbrojtur Misionin Britanik, në kohët e vështira të dimrit të vitit 1943-44. Baba Faja vuri në dispozicion të misionit britanik dhe mbrojtjes së jetës së tyre shtëpinë, pasurinë dhe njerëzit që i shërbenin. Dejvisi kujton: “shkova të takoj Baba Fajën, për t’i thënë që të bënte diçka, për të përmirësuar kushtet tona të jetesës, pasi ai me Këshillin banonin nëpër shtëpi, ndërsa Misioni Anglez gjendej në plevicë, bashkë me mushkaxhinjtë. Baba Faja u zhvendos në një shtëpi tjetër dhe na e lëshoi dhomën ku kishte qëndruar vetë. Kushtet e banimit, shkruan Dejvis, u përmirësuan kryekëput”⁷. Baba Faja përbënte një pikë referimi dhe shpëtimi për anëtarët e Misionit. Më 30 dhjetor 1943 tre anëtarë të Misionit Britanik Çizshajër (Cheshire), Her (Allen Her) dhe Çisholm (B.A.Çizëm), që ishin ndarë nga pjesa tjetër e misionit në Bizë të Martaneshit, gjetën strehim, ushqim dhe fjetje tek Baba Faja, pas disa ditë endjeje dhe fshehjeje në pyll. Roderick Bejli sjell në gojën e majorit Bill Mclean shprehjen e mëposhtme për Baba Fajën: “Baba Faja, përmend ai, ishte një klerik bektashi me mjekër të madhe, ndërsa Myslim Peza, një bandit i shkollës së vjetër jashtë ligjit. Të dy këta burra, vazhdon ai më tej, ishin në moshë mesatare, paksa të modës

⁷ Gjenerali Davies, *Aventura Ilire, Historia e Misionit Ushtarak Britanik në Shqipërinë e pushtuar nga armiku 1943-1944*, Tiranë: 1955, f.112-113.

së vjetër, besimtarë jo të mirë, pijetarë të thekur por kishin influencë lokale, sharm dhe guxim të madh personal”⁸.

Në ditarin e datës 3 janar 1944, koloneli Nikolls përshkruan për periudhën, para se misioni britanik të bujtte në shtëpinë e Baba Fajës: “Natë me të ftohtë të hidhur. Të gjithë po përballen me mërzitjen dhe kufizimin e të qenit në një dhomë, në katin e dytë të një shtëpie të vogël, për më shumë se një javë. Në mëngjes, në mënyrë të papritur shohim se i zoti budalla i shtëpisë dhe djemtë e tij kishin ikur, duke na lënë neve komplet pa mbrojtje, ..duhej të iknim shpejt. Ne u drejtuam për në Kostenjë, në fshatin e Baba Fajës, dhe arritëm atje në mbrëmje, ku për gëzimin dhe surprizën tonë të madhe gjetëm Çizshajër, Her dhe Çisholm”⁹. Në ditarin e kolonel Nikolls të datave 6-8 janar 1944, gjenden përshkrime të jetesës së vështirë, të 13 anëtarëve të Misionit në kasollen e Baba Fajës, në fakt stani i tij, dhe për motin e ftohtë. Por pas kërkesës së anglezëve, ai u liroi dhomën ku rrinte vet..., ndërsa në datën 8 janar përshkruhet skena e rrethimit të Misionit Britanik dhe rënia rob e gjeneralit Dejvis, pasi ai kishte marrë dy plagë si dhe e dy anëtarëve të tjerë të Misionit.

Burimet amerikane të kohës së luftës që ne njohim, pothuajse nuk e përmendin Baba Fajën për shkak të mungesës së kontakteve me të. Por ai bëhet i dukshëm në vitet 1945-1946. Piter Lukas- autori i librit për misionin amerikan në Shqipëri, të përkthyer së fundi në shqip, shkruan se, Baba Faja dhe të tjerë persona si Omer Nishani, Mehmet Shehu, Ramadan Çitaku, Dali Ndreu kishin vizituar Misionin Amerikan të OSS në Tiranë, para datës 11 shkurt të vitit 1945¹⁰.

Më 9 maj 1945, një ditë pas ardhjes në Shqipëri të Misionit Civil Amerikan të kryesuar nga Joseph Xhejkobs*, selinë e tij do ta vizitonte një delegacion bektashian, i përbërë nga kolonel Baba Faja Martaneshi, gjysh Myrteza Kruja, Xhelal Rusi dhe major Haxhi Seseri. Ata do të shprehnin kënaqësinë për ardhjen në vendin e tyre të përfaqësimit civil të

⁸ Roderick Bailey, *The Wildest Province, SOE in the Land of the Eagle*, Random House Group Limited, Great Britain, 2008, Published by Vintage 2009, p.64.

⁹ *Po aty*, f.115.

¹⁰ Piter Lucas, *Misioni Amerikan në Shqipëri*, Tiranë: “Bota Shqiptare”, 2008, f.277.

* Joseph Jacobs ishte shëf i Misionit Civil jo Zyrtar të SHBA në Shqipëri në periudhën maj 1945-tetor 1946.

SHBA. Ata, shkruan Xhejkobs në ditarin e tij më informuan, se Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Bektashian e njëjtte Qeverinë Demokratike të Shqipërisë dhe Shqipëria, sipas opinionit të tyre, duhej të ftohej për të marrë pjesë në Konferencën e San Franciskos. Grupi ishte i përzemërt dhe gjatë gjithë kohës më shprehu ndjenjat miqësore ndaj Shteteve të Bashkuara¹¹.

Në vitet e para të pasluftës shteti vazhdoi të ruante ligjet e Zogut mbi fenë në vend, por u përpoq t'i manipulonte ato. Përpjekjet e tij u përqendruan tek vendosja e kontrollit mbi drejtuesit e komuniteteve fetare në Shqipëri, për t'i katandisur ata në "kukulla të drejtuara nga shteti". Një raport i Misionit Britanik në Shqipëri, në mars 1946, do të theksonte se, në këtë muaj shtypi shqiptar kishte botuar një artikull, i cili i sulmonte për herë të parë hapur bektashinjtë, duke e quajtur shtypin e tyre "reaksionar"¹². Misionet britanike dhe amerikane në Tiranë do të konstatonin, se bektashinjtë, kohët e fundit, kishin humbur shumë nga influenca e tyre. Sipas dokumentacionit amerikan të kësaj periudhe mbi bektashinjtë shqiptarë po ushtrohej shtypje dhe dhunë. Rrjedhojë e kësaj politike konsideroheshin edhe përpjekjet e Baba Fejzës dhe të Baba Fajës për t'i imponuar Gjyshit Botëror, Dede Abazi idetë e tyre mbi demokratizimin dhe organizimin fetar të bektashinjve, të cilat përfunduan tragjikisht me vrasjen e të treve.

Besoj dhe mendoj se burimet e përmendura më lart për Baba Fajën, nuk janë të vetmet. Njohja më e mirë e dokumenteve arkivore britanike e ndofta amerikane për kohën e luftës, do të na krijonin mundësinë për të paraqitur më të plotë figurën e Baba Fajës, e cila pa asnjë dyshim mbart vlera të çmuara për gjithë shqiptarët.

¹¹ Hamit Kaba, "Ditar i Joseph Jacobs", *Studime Historike*, nr. 1-2, Tiranë 2006, f.187.

¹² NARA, Roll 2, 1945-1949, Raport i Misionit Britanik në Shqipëri, mars 1946, f.8.

